



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 172/2023
Datë: 23 shkurt 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 23 shkurt 2023, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Raporti i Komisionit për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, KPK/KATPSH i datës 17 janar 2023 për avancimin e tre (3) prokurorëve në Prokurorinë e Apelit në Prishtinë, si në vijim:
 1. Z. Shkëlzen Ibrahim, avancohet nga Departamenti i Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Prokurorinë e Apelit.
 2. Znj. Sheribane Selimi-Muçaj, avancohet nga Departamenti për të Mitur i Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Prokurorinë e Apelit.
 3. Z. Naim Beka, avancohet nga Departamenti i Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë në Prokurorinë e Apelit.
- II. Për prokurorët e cekur në pikën I këtij vendimi të hartohen vendime të veçanta dhe të jenë pjesë e dosjes personale të tyre.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP;
- Arkivit të KPK-së.